



UNIVERSITETI I TIRANËS



REKTORATI

Këshilli Studentor

SHESHI "NËNË TEREZA" REKTORATI I UT, TIRANA, ALBANIA, CEL: +355 66 70 20 116

E-mail: keshillistudentor.ut@gmail.com

Drejtuar: Rektorit te Universitetit te Tiranes prof . dr Dhori KULE

Lenda : Mbi projekt ligjin e arsimit te larte

Këshilli Studentor i Universiteti të Tiranës pasi mori në dorëzimi projektligjin e arsimit të lartë vendosi të mbajë një mbledhje me të gjitha strukturat studentore dhe vendosi të iu paraqesë keto pikpamje në lidhje me ato ndryshime që në menyre të drejtperdrejte prekin studentet.

Në parim ky projektligj nuk ka mbështetjen e strukturave tona studentore pasi e vlersojmë se mbi të gjitha ky ligj ul nivelin e përfaqesimit të studentëve dhe ka tendencen të uli fuqinë e studentëve në përfaqesimin e tyre. Imponon qartazi që kosto të iu kaloi studenteve dhe familjeve të shqiptarëve të cilet zgjedhin universitetet publike. Ndërkohe ndër te tjera ne këte materjal do të iu paraqesim mendimet tona duke bërë një analizë më të detajuar të disa prej neneve më kryesore

A)Roli i Shtetit në Arsimin e lartë dhe përballimi i Kostove të studimeve prej tij në përmbushje të nenit 57/3 të Kushtetutës

Arsimii lartë, në bazë të Kushtetutës e specifikisht nenit 57/4 është një e drejtë themelore e llojit pozitiv. Kjo do të thotë që është nga ato të drejta e cila jo vetëm nuk mund të sigurohet për subjektet e së drejtës vetvetiu, por kërkon ndërhyrjen e drejtëpërdrejtë të shtetit nëpërmjet ofrimit të këtij shërbimi. Njësoj si arsimi i detyrueshëm dhe ai i mesëm, arsimi i lartë është një e drejtë që ofrohet nga shteti vetëm me rezervën kushtetuese që përcaktohet në nenin 57/4, dhe që është aftësia e studentëve. Do të thotë që ajo është një e drejtë e llojit pozitiv që ofrohet si shërbim nga shteti vetëm për më të aftët dhe jo për të gjithë kandidatët për studentë. Matura shtetërore është formula juridike se si shteti përcakton më të aftët që do tju ofrohet ky shërbim.

Kjo është arsyeja se përse ligji në fuqi i arsimit të lartë përcaktonte detyrimin e shtetit për financimin e institucioneve të arsimit të lartë publik nëpërmjet granteve të pakushtëzuara dhe minimalisht deri në nivelin që këto institucione të ofrojnë shërbimin me një standard të caktuar. Konkretisht neni 73/2 I ligjit të vjetër të arsimit të lartë specifikonte se: " Këshilli i Ministrave, përmes Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, u jep institucioneve publike të arsimit të lartë fonde për përmbushjen e misionit të tyre sipas standardeve". Me pak fjalë, nëpërmjet ligjit, shteti sanksiononte detyrimin e qeverisë për përballimin e kostove të studimeve të studentëve që kishin

përfitur të drejtën e arsimit të lartë në institucionet publike. Aq e vërtetë është kjo, sa që nga hyrja në fuqi e ligjit ekzistues të arsimit të lartë, dhe deri vitin e kaluar, rrogat bazë të pedagogëve (që përbëjnë dhe koston e studimeve të studentëve të publikut) janë përballuar në mënyrë të plotë nga buxheti i shtetit madje nga granti i pakushtëzuar i tij për Institucionet publike të arsimit të lartë dhe jo nga tarifat e studentëve. Kjo sepse edhe në kuptim të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, arsimi I lartë publik është një shërbim publik që si gjithë të tjerët ofrohet nga shteti.

Projektligji i ri praktikisht shkarkon shtetin nga detyrimi për përballimin e kostove të studimeve të studentëve të publikut, duke ja kaluar këtë kosto vetë studentëve dhe familjeve të tyre, dhe duke shkelur në këtë mënyrë me të dyja këmbët të drejtën themelore për arsim të lartë.

Që në fillim të ligjit të ri ku përcaktohet roli i shtetit në arsimin e lartë, ndryshe nga ligji i vjetër që sic thamë përcaktonte detyrimin e shtetit për financimin në funksion të përmbushjes së misionit, qartësohet prirja që kostot të mund ti kalojnë gradualisht studentëve

Neni 3

Roli i shtetit në arsimin e lartë

Shteti, përmes përcaktimit të përparësive të zhvillimit dhe të interesave strategjikë të vendit, vë në dispozicion fonde publike për mbështetjen e programeve të caktuara të studimit ose fushave të caktuara të kërkimit shkencor.

B) Me Projektligjin e ri studentëve për herë të parë ju kalohen kostot e studimeve të tyre dhe shteti tërhiqet nga detyrimi për përballimin e kostove të arsimit të lartë për studentët e Institucioneve Publike të Arsimit të lartë

Ndryshe nga i vjetri, projektligji i ri ju lë vetë institucioneve të arsimit të lartë të drejtën e përcaktimit të tarifave të studimit, dhe në mënyrë të tërthortë detyron këto të fundit që tju kalojnë nëpërmjet tarifave të arsimimit vetë studentëve kostot e studimeve të tyre. Po citoj disa nene të Projektligjit të ri të cilat sëbashku qartësojnë përpjekjen e ligjit që kostot e studimeve ti përballojnë në të ardhmen vetë studentët dhe jo Buxheti i Shtetit.

Neni 4

Autonomia e institucioneve të arsimit të lartë

Autonomia financiare garantohet nëpërmjet të drejtës:

a) Për të krijuar të ardhura të ligjshme nga veprimtaritë e mësimdhënies, nga veprimtaritë kërkimore-shkencore, të drejtat intelektuale, nga markat dhe patentat, nga shërbimet, nga veprimtaritë artistike e sportive, si dhe nga veprimtari të tjera ekonomike, të cilat përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b)për të përfituar fonde nga shteti dhe organizma të tjerë;

c) për të përcaktuar tarifat e studimit në përputhje me këtë ligj;

Neni 38

Hapja dhe mbyllja e programeve të studimit në institucionet e arsimit të lartë

4) Ministri përgjegjës refuzon kërkesën në rastet kur institucioni i arsimit të lartë nuk përmbush kushtet për hapjen e programit të studimit ose nuk provon se është në gjendje të ofrojë garancitë e nevojshme financiare dhe infrastrukturën përkatëse për veprimtarinë e kërkuar.

Neni 116

1.Burimet e financimit të institucioneve të arsimit të lartë

Për të gjitha institucionet e arsimit të lartë burimet e financimit janë:

A) Të ardhura nga pagesat e studentëve për arsimim. Në institucionet publike të arsimit të lartë niveli minimal dhe maksimal i tarifave për arsimim përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave;

C) Projektligji krijon një skemë e cila nxit organet vendimarrëse që kostot e studimeve tju kalojë studentëve dhe shteti të ul nivelin e kontributit të tij për arsimin e lartë publik

Jo vetëm që tarifa e studentëve tashmë lihet në diskrecionin e Institucionet të arsimit të lartë, por këto të fundit nxiten nga ligji që pjesën më të madhe të të ardhurave ta krijojnë nga pagesat e studentëve. Kjo sepse nga njëra anë në bazë të këtij projektligji Këshilli i Ministrave ka diskrecion të plotë dhe asnjë kufizim ligjor për masën e kontributit të buxhetit të shtetit për Institucionet Publike të Arsimit të Lartë dhe nga ana tjetër si e vetmja mënyrë që stafet akademike të kenë shumicën në Bordin e Administrimit që kryen në bazë të projek ligjit të ri të gjitha funksionet organizative të Institucionit të Arsimit të Lartë.

Ne kundërshtojme në parim krijimin e Bordit të Administrimit pasi ai mbi të gjitha ul nivelin e perfaqesimit të të gjitha njesive kryesore të Universitetit si dhe nuk parashikon perfaqesimin e studenteve.

Neni 15

Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë

1) Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL) është institucion publik që ka për detyrë kryesore shpërndarjen e fondeve publike për:

a) mbështetjen e veprimtarisë së institucioneve publike të arsimit të lartë.

2) AKFAL propozon kriteret dhe formulat e shpërndarjes së fondeve publike të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3) Këshilli i Ministrave miraton çdo vit Letrën e Prioriteteve sipas propozimit të Ministrit përgjegjës për arsimin

Neni 51

Përbërja dhe krijimi i bordit të administrimit

Përbërja e bordit të administrimit përcaktohet në varësi të planit buxhetor afatmesëm të institucionit publik të arsimit të lartë, të miratuar nga bordi. Nëse Institucioni siguron vetë 50% ose më shumë të nevojave të financimit, katër prej anëtarëve janë përfaqësues të IAL-së dhe tre janë përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse për arsimin. Në rastet kur Institucioni siguron vetë më pak se 50% të nevojave të financimit tre prej anëtarëve janë përfaqësues të IAL-së, dhe katër janë përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse për arsimin. Në rastet kur njësi e qeverisjes vendore në territorin e së cilës zhvillon veprimtarinë institucioni i arsimit të lartë kontribuon financiarisht së paku në masën prej 10% të burimeve financiare të IAL-së atëherë një prej përfaqësuesit që i takon Ministrisë përgjegjëse për arsimin, përcaktohet nga njësi e qeverisjes vendore.

D) Sipas projektligjit të ri Fondet Shtetëore për institucionet e arsimit të lartë shpërndahen me një skemë antikushitetuese dhe jo të drejtë

Ligji vërtet përcakton se Buxheti i shtetit do të financojë Institucionet e Arsimit të Lartë, por masa e këtij financimi mbetet në diskrecion të vetë ekzekutivit, ai është I pamjaftueshëm dhe abuziv, duke I vënë në pozita diskriminuese institucionet e arsimit të lartë publik ekzistues dhe shpërndahet në mënyrë antikushitetuese.

Neni 117

Shpërndarja e fondeve nga Buxheti i Shtetit

Fondet nga Buxheti i Shtetit shpërndahen në formë granti, sipas kategorive të mëposhtme:

- a) Granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë;
- b) Granti i mësimdhënies;
- c) Granti i punës kërkimore-shkencore.

Jo vetëm që projektligji lë në diskrecionin e qeverisë masën e financimit të institucioneve të arsimit të lartë, por dhe vetë financimi buxhetor që parasheh ky projekt ligj është antikushitetues dhe I vë në pozita jo të barabarta institucionet e arsimit të lartë publik me ato të arsimit të lartë privat (që ky ligj e quan institucione të arsimit të lartë të pavarur publik)

Së pari ky projektligj (pika b e nenit 117, e sipërcituar) prashet financim të njejtë për të gjithë studentët e bachelor në të gjitha institucionet e arsimit të lartë, si ata që janë pranuar në një institucion publik nëpërmjet formulës përzgjedhëse ashtu edhe ata të pranuar në institucionet private pa një formulë të tillë. Kushtetuta jo pa kast në nenin 57/4 ju garanton të drejtën e arsimit të lartë vetëm më të aftëve. Më të aftët përcaktohen nga formula juridike e përcaktuar nga ligji (që nga 2007 e në vijim kjo formulë është matura shtetërore).

Institucionet private të arsimit të lartë pranojnë studentë vetëm përkundrejt tarifave dhe nuk është e drejtë që një student I privatit të përfitojë njësoj nga fondet buxhetore publike si ai që ka kaluar formulën përzgjedhëse dhe duhet ti ofrohet ky shërbim pikërisht në zbatim të nenit 57/4 të Kushtetutës. Kushtetuta ka vendosur detyrim për shtetin të financojë vetëm studimet e studentëve më të aftë. Më të aftët përcaktohen nga një konkurim kombëtar (sot matura shtetërore, ky projektligj duket sikur vendos si kriter vlerësues vetëm mesataren e gjimnazit) dhe studimet e tyre financohen nga buxheti I shtetit duke përballuar kostot e institucioneve publike të arsimit të lartë nga buxheti I shtetit. Financimi me fonde publike të studentëve që nuk janë përzgjedhur nga konkursi kombëtar si më të aftët, është një shkelje e rëndë e kushtetutës.

Në castin e barazimit të financimit midis institucioneve të arsimit të lartë, institucionet aktuale publike të arsimit të lartë janë haptazi të pabarabartë në garën e konkurrencës për përfitimin e fondeve buxhetore në kuptim të nenit 117/a/c (e sipërcituar) përball institucioneve private të arsimit të lartë. Sic përcakton projektligji në fjalë, institucionet do të duhet të konkurojnë pranë

ekzekutivit për grantin shtetëror të politikave të zhvillimit të arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor.

Dihet se institucionet aktuale publike të arsimit të lartë kanë pasur gjatë gjithë këtyre viteve një buxhet shumë më të ulët krahasuar me institucionet private të arsimit të lartë të cilat financoheshin drejtëpërsëdrejti nga klientët e tyre nëpërmjet tarifave që i përcaktonin në treg të lirë. Gjithë ky historik ka bërë që institucionet private të arsimit të lartë të kenë zhvilluar shumë më shumë gjatë këtyre viteve burimet e tyre njerëzore, infrastrukturën shkollore dhe didaktike dhe infrastrukturën kërkimore shkencore. Në këto kushte, nëq këto institucione jo të barabarta për nga mundësitë e konkurimit I vendosim në kushte të tilla, është e qartë se disa institucione të arsimit të lartë janë më të favorizuara dhe disa të tjera e kanë të pamundur konkurimin.

E)

Neni 102

Fitimi, ndërprerja, dhe humbja e statusit të studentit

1-Statusi i studentit fitohet me regjistrimin e tij në një institucion të arsimit të lartë. Ky status humbet me marrjen e diplomës ose çertifikatës përkatëse, si dhe në rastin e çregjistrimit të studentit nga ai institucion.

2-Studenti mund t'i pezullojë studimet dhe t'i rifillojë ato në përputhje me rregullat e përcaktuara nga njësia kryesore, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

3-Studenti nuk mund të regjistrohet njëkohësisht në më shumë se një program studimi.

Pika 3 mendojme se duhet ndryshuar që studentit të ketë mundësi të ndjekë më shumë se një program studimi por që të mos të jetë i njëjti program studimi prsh një student i Masterit mund të nisi një program studimi në bachelor.

Ne këtë projektligj ndër të tjera parashikohet që në zgjedhjet për drejtuesit e njësive kryesore në Universitet, studentëve t'u hiqet e drejta e votës. Mbi të gjitha ligji ekzistues sanksiononte fuqinë e studentëve e cila duhej respektuar nga kandidatet për Dekan dhe Rektor të çdo fakulteti dhe universiteti publik në vend.

Këshillat Studentore - organet që përfaqësojnë interesat akademike, sociale, ekonomike dhe kulturore të studentëve nuk parashikohet të financohen. Qeveria jo vetëm që nuk mbështet studentët por duke mos i mbështetur ata synon të ulë fuqinë e organizimeve të tyre, pra rrjedhimisht synon t'i nënshtroje ata duke ulur fuqinë e tyre.

Këto janë ato mendimet e perbashkëta të cilat ne si përfaqësues të studentëve rreth këtyre temave parashikojmë.

Ju falenderojmë për bashkpunimin.

Kryetari

Emiljano DERVISHI